

STATUT
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
SE & NI construction

KREU I

Themelimi , Emri , Objekti , Kohezgjatja dhe Selia

Neni 1 : Data e themelimit , Emri dhe themeluesit

Sot me date 01.07.2020 , kerkohet themelimi i shoqerise me pergjegjesi **SE & NI construction** dhe formulimi i statutit te saj si me poshte vijon, ne perputhje me ligjin 9901 date 14.04.2008 “ Per tregtaret dhe shoqerite tregtare “ nga ortaket:

Z. Elton Seni, i datelindjes 16.10.1988 ,lindur ne Gramsh, me nenshtetesi Shqiptare, madhor, me zotesi juridike për të vepruar, me numer karte identiteti I81016003D.

Z. Dhimiter Nina, i datelindjes 29.07.1983, lindur ne Durres Shqiperi, madhor, me zotesi juridike per te vepruar, me numer karte identiteti I30729086F

Neni 2 : Objekti

Si objekt I shoqerise eshte Ndertim. Punime elektrike, punime hidraulike. Import eksport te materialeve te ndertimit

Neni 3 : Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqerise do jete pa afat .

Neni 4 : Selia

DURRES, Lagjja nr. 17, Rruga " Stefan Kaculini" Pallati " A 1993 " , Kati i dyte, Zona Kadastrale 8515.

KREU II
KAPITALI I RREGJISTRUAR

Neni 5 : Vlera dhe pagesat e kapitalit te rregjistruar

Kapitali i shoqerise eshte 100.000 (njeqindmije) Leke , i ndare ne 2 kuota.

Kontributi i ortakeve ne kapitalin e shoqerise eshte vleresuar sipas te dhenave te meposhtme :

Z. Elton Seni i cili zoteron 1 (nje) kuote , me 50 % te pjesemarrjes ne kapitalin e shoqerise, me 50000 leke kontribut ne kapital.

Z. Dhimiter Nina I cili zoteron 1 (nje) kuote, me 50 % te pjesemarrjes ne kapitalin e shoqerise, me 50000 leke kontribut ne kapital.

Neni 6 : Pagesa e kuotave

Administratoret mund ti kerkojne ortakeve pagimin e kontributeve ne para te pashlyera ne lidhje me kuotat e tyre .

Neni 7 : Kalimi i kuotave

Kalimi i kuotave dhe i te drejtave qe rrjedhin prej tyre , mund te behet me kontrate shitblerje , me dhurim , me trashegimi ose me cdo menyre tjeter te parashikuar me ligj .

Neni 8 : Zmadhimi e zvogelimi i kapitalit themeltar

Asambleja e Pergjithshme , me shumice te kualifikuar , mund te zmadhoje kapitalin themeltar te shoqerise duke rritur kuotat e ortakeve ekzistues ne shumen e percaktuar ne vendimin perkates. Zmadhimi i kapitalit me qellim pranimin e ortakeve te rinj ne shoqeri, miratohet nga Asambleja e Pergjithshme me shumicen e kualifikuar te votave te ortakeve . Shoqeria mund te vendose zvogelimin e kapitalit themeltar te shoqerise me vendimin e Asamblese se Pergjithshme , te marre me shumice te kualifikuar te votave .

Kreu III

Asambleja e Pergjithshme

Neni 9 : Te drejtat dhe detyrimet

Asambleja e Pergjithshme eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme :

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise ,
- b) ndryshimet e statutit ,
- c) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve ,
- d) emerimin dhe shkarkimin e likuidatoreve dhe eksperteve kontabel te autorizuar ,
- e) mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret , perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise ,
- f) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit ,
- g) pjesetimin e kuotave dhe anullimin e tyre ,
- h) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve ,
- i) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise ,

- j) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese ,
- k) ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti .

Neni 10 : Thirrja e Asamblese se Pergjithshme

- a) Asambleja e Pergjithshme thirret nga administratori te pakten 2 here ne vit , per te miratuar perkatesisht bilancin vjetor te mbyllur dhe bilancin vjetor parashikues .
- b) Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme thirret nepermjet nje shkrese derguar cdo ortaku me poste te zakonshme ose mesazh elektronik . Njoftimi duhet te kryhet te pakten 7 dite perpara dates se caktuar per mbledhjen .
- c) Ortaket ,qe zoterojne te pakten 30% te kapitalit te rregjistruar kane te drejte te therrasin mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme nepermjet administratorit ose dhe pa ndermjetesimin e tij .

Neni 11 : Mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme

- a) Mbledhja e Asamblese eshte e vlefshme nese ne te marrin pjese ortake qe zoterojne me shume se 30% te aksioneve , per te vendosur per ceshtje te zakonshme. Ne kete rast vendimi i Asamblese eshte i vlefshem nese eshte votuar nga shumica e votave te ortakeve pjesemarres ,(e cilesuar ne kete statut si “ shumice e thjeshte “) .
- b) Mbledhja e Asamblese , per te vendosur per ceshtje te vecanta si : ndryshimi i statutit , zmadhimi ose zvogelimi i kapitalit te rregjistruar , shperndarja e fitimeve , riorganizimi dhe prishja e shoqerise , eshte e vlefshme , eshte e vlefshme nese ne te marrin pjese ortake qe zoterojne me shume se 61% te kuotave . Ne kete rast vendimi i Asamblese eshte i vlefshem nese eshte votuar nga jo me pak se tre te katertat e votave te ortakeve pjesemarres ,(e cilesuar ne kete statut si “ shumice e kualifikuar “) .
- c) Mbledhja e Asamblese drejtohet nga administratori nese eshte e thirrur prej tij . Nese Asambleja e Pergjithshme eshte thirrur nga pakica , atehere ajo kryesohet nga njeri nga ortaket e zgjedhur nga pjesemarresit ne ate mbledhje .
- d) Administratori pavaresisht se nuk eshte ortak , ka te drejten e pjesemarrjes si edhe te marri fjalen ne cdo mbledhje te Asamblese se pergjithshme .

Neni 12 : Votat e Pjesemarresve

- a) Cdo ortak ka te drejta vote ne perpjesetimin me vleren nominale te kuotes se tij .
- b) Asnje ortak nuk voton ne mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme nese nuk ka shlyer teresisht detyrimet , qe kane te bejne me kuotat , qe ai disponon .

Neni 13 : Emerimi i Administratorit

- a) Administrimi si dhe perfaqesimi i shoqerise i besohen nje ose me shume Administratoreve qe mund edhe te mos jene ortake .
- b) Administratori emerohet maksimumi per 5-vjet nga regjistrimi i shoqerise prane QKB-se , me te drejte ripërteritje , me perjashtim doreheqje apo shkarkimi nga ana Asamblese .
- c) Detyra e Administratorit i ngarkohet **Z. Sotjon Seni** i datelidjes. 14.07.1985, lindur ne Gramsh, me numer karte identiteti I50714089C, te cilit i jepet e drejta e firmes dhe e perfaqesimit te shoqerise .
- e) Asambleja e Pergjithshme mund te shkarkoje ne cdo kohe Administratorin nga detyra , me shumice te zakonshme votash , me kusht qe ne mbledhje te marrin pjese ortaket me te drejte vote , qe zoterojne me shume se 97% te kuotave .

Neni 14 : Kompetencat e Administratorit

Administratori ka te drejte dhe detyrohet :

- a. te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise , duke zbatuar politikat tregtare , te vendosura nga Asambleja e Pergjithshme ,
- b. te perfaqesoje shoqerine ,
- c. te kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe te librave kontabel te shoqerise ,
- d. te beje te mundur pergatitjen nga specialisti i ngarkuar dhe te nenshkruaje bilancin vjetor parashikues per vitin e ardhshem , per tu miratuar nga Asambleja e Pergjithshme , brenda dates 20 tetor te vitit paraardhes .
- e. te beje te mundur pergatitjen nga specialisti i ngarkuar dhe te nenshkruaje bilancin vjetor te mbyllur , per tu miratuar nga Asambleja e Pergjithshme , brenda dates 20 mars te vitit te ardhshem dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe , se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve , i paraqet keto dokumente perpara Asamblese se Pergjithshme per miratim ,
- f. te krijojte nje sistem monitorimi e njoftimi te hershem per rrethanat qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise ,
- g. te kryejne regjistrimet e publikimet e detyrueshme te te dhenave te shoqerise
- h. te raportoje perpara Asamblese se Pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare ,

- i. te kryeje detyra te tjera , te percaktuara ne ligj dhe statut .

Neni 15 : Mbledhjet e Administratorit

Administratori kujdeset qe ne libra te posacem te mbaje proces verbalet e te gjitha takimeve te kryera nga ai , si dhe te gjitha mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme .

Kreu VI

Shperndarja e fitimit vjetor te shoqerise

Neni 16 : Shperndarja e fitimit vjetor

- a) Pjesa e fitimit qe i takon secilit ortak nga vlera e fitimit vjetor te deklaruar ne pasqyrat financiare te shoqerise , vendoset te shperndahet nga Asambleja e Pergjithshme .
- b) Asambleja e Pergjithshme ka kompetence t'u shperndaje ortakeve pjesen e fitimit ne raport me vleren e kapitalit te regjistruar , qe kuotat e secilit ortak perfaqesojne .
- c) Po ashtu , Asambleja e Pergjithshme mund te vendose qe nje pjese e fitimit vjetor te mos u shperndahet ortakeve , por keto shume te perdoren per zmadhimin e kapitalit fillestar apo per qellime te tjera , te cilat ajo i konsideron te dobishme per shoqerine .

Kreu VII

Prishja dhe njoftimet

Neni 17 : Prishja dhe likuidimet

- a) Ne rast te likuidimit te shoqerise , Asambleja e Pergjithshme emerone nje likuidator , i cili administron shoqerine deri ne mbylljen e procesit te likuidimit .
- b) Me vendimin e posacem te Asamblese se Pergjithshme , te marre me shumice te kualifikuar , pasi jane shlyer detyrimet ligjore ndaj kreditorëve te shoqerise , likuidatori shperndan pjesen e mbetur te pasurise se shoqerise ndermjet ortakeve . Kjo shperndarje e fundit behet ne raport me vleren e kapitalit te regjistruar , qe kuotat e secilit ortak perfaqesojne .

Neni 18 : Ftesa per kreditorët

Likuiduesit duhet te ftojne kreditorët per te depozituar pretendimet e tyre per prishjen e saj . Shoqeria e publikon dy here kete njoftim , me nje interval prej 30 ditesh , ne faqen e saj te internetit , si dhe ne faqen e internetit te Qendres Kombetare te Biznesit . Ne njoftim duhet deklaruar se pretendimet duhet te depozitohen brenda 30 diteve nga data e njoftimit te fundit .

Neni 19 : Perfundimi i likuidimit

- a) Pas shperndarjes se aktiviteteteve te mbetura, likuiduesi e njofton Qendren Kombetare te Biznesit per perfundimin e likuidimit dhe kerkon cregjistrimin e shoqerise.
- b) Veprimtaria e likuiduesit nuk mund te kundershohet pas cregjistrimit te shoqerise nga Qendra Kombetare e Biznesit.

Neni 20 : Dispozitat perfundimtare

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj ne perputhje me normat e ketij statuti .
Per cdo gje tjeter , qe nuk eshte shkruar shprehimisht ne kete statut , zbatohet legjislacioni ne fuqi per shoqerine tregtare , per QKB-ne si dhe cdo ligj tjeter mbi veprimtarine e shoqerive me eprgjegjesi te kufizuar .

Ortaket e shoqerise

ELTON SENI

Elton Seni


DHIMITER NINA

DHIMITER NINA
